



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

NR. 276 REGJISTRI
Datë 16.06.2020 Regjistrimi

NR.1952 VENDIMI
Datë 21.09.2020 Vendimi

VENDIM
"Në emër të Republikës"

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtari Avni SEJDI

Asistuar nga sekretaria gjyqësore **Griselda DORESI**, në Tiranë sot me datë 21.09.2020, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. 2766, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: **Federata Shqiptare e Futbollit**, me seli në Tiranë, adresa: Rruga "Liman Kaba" Nd.5, Hyrja 1, Njësia Administrative 5, Kodi Postar 1019, me përfaqësues ligjor **Z.Armand Duka**, e përfaqësuar në gjykim nga **Av. Julian Mërtiri**, me Nr.Liçence profesionale 3341 dhe NUIS K924090090, pajisur me autorizimin datë 09.07.2020, Anëtarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë

IPADITUR: **Autoriteti i Konkurrencës**, me seli në Tiranë, me adrese Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga **Z. Indrit Reka** identifikuar me letërnjoftim nr. 024434326, **Z.Niku Meko** identifikuar me letërnjoftim nr. 034292022 dhe **Znj.Anisa Buxheri**, identifikuar me letërnjoftim 036183423, të pajisur me autorizim Nr. 25/29 prot., datë 13.07.2020.

Me pjesmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga **Znj. Albana Plloçi** në mungesë.



RR 461 212 910 AA

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendim nr.693, datë 14.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës “Për kostatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqipëtare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”.

BAZA LIGJORE: Nenet 1/2 7, 11, 15/a, 17/a të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”;
Ligji nr. 9121, date 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar ;
Ligji nr.79/2017 “Për sportin”;
Rregullore “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Gjykata, si mori në shqyrtim çështjen, si shqyrtoi dhe administroi provat e paraqitura nga palët, si dëgjoji bisedimet përfundimtare të tyre të cilët në përfundim kërkuan:

Pala paditëse Federata Shqipëtare e Futbollit nëpërmjet përfaqësuesit Av.Julian Mërtiri:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Pala e paditur Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet përfaqësuesve Z. Indrit Reka, dhe Z.Niku Meko dhe Znj. Anisa Buxheri:

Rrëzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata, si shqyrtoi aktet dhe e bisedoi në tërësi çështjen.

VËREN SE

Pala paditëse Federata Shqiptare e Futbollit, i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar sipas objektit.

Gjykata, referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë, në mbështetje të nenit 7, gërma “a” 10/1 dhe 11/1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, kryesisht konstaton është kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështje dhe se mosmarrëveshja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Për të bërë të mundur përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit në këtë gjykim, bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, padia dhe aktet shoqëruese të saj ju njoftuan Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, e cila u përfaqësua në këtë gjykim nga Znj. Albana Plloçi.

- **Rrethanat e çështjes:**

Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF), është person juridik i regjistruar dhe e organizuar në formën e një organizate jofitimprurëse (Shoqatë), e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të futbollit, në Republikën e Shqipërisë. Regjistrimi i saj në regjistrin e organizatave jofitimprurëse është bërë me Vendimin nr.9, datë 31.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, gërma “a”, të Ligjit Nr 9121/2003 *"Për mbrojtjen e konkurrencës"*, i ndryshuar, ka realizuar një monitorim në sektorin e sportit të futbollit, si treg në të cilën kryhet veprimtari ekonomike mbështetur në praktikat e trajtuara nga Komisioni Evropian dhe Autoritetet e Konkurrencës në BE, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të Ligjit 9121/2003, i ndryshuar.

Në përfundim të monitorimit, Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 9, e 24 shkronja “d” dhe nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 *"Për mbrojtjen e konkurrencës"* i ndryshuar, me Vendimin Nr. 583, date 17.01.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.564, datë 25.10.2018 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF).

Në përfundim të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës ka konkluduar se: sjellja e FSHF-së, në tregjet përkatëse si: (i) Shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë 7 vjet, duke përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, duke u bërë përjashtuese për operatorët e tjerë; (ii) çmime të shitjes së biletave të larta krahasuar me rajonin, e të pambeshtetura në një metodologji të miratuar, mund të kufizojnë konkurrencën dhe të përbëje abuzim me pozitën dominuese referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 9121/2003 *"Për mbrojtjen e konkurrencës"*, me pasoja për konkurrencën në treg.

Për sa me sipër, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 607, date 01.04.2019, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe për të parë nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2015 deri në 31.12.2018.

Me Vendimin nr.632, datë 20.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.607, datë 01.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj

federatës Shqiptare të Futbollit” Komisioni i Kokurrencës ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit të thelluar duke përfshirë periudhën kohore 01.01.2015 deri në 30.04.2019.

Në përfundim të hetimit administrativ, me aktin administrativ objekt gjykimi, Vendimin Nr. 693, datë 14.05.2020, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF si entitet të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv; shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama.

2. Dhenien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF.

a. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprim dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t’u shiten operatorëve të ndryshëm.

b. Detyrimin e FSHF në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesmarrje sa më të gjërë për operatorët audioviziv.

c) Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “Highlighte” dhe krijimin e mundësive për pjesmarrje sa më të gjërë për operatorët audioviziv.

3. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtës televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.

4. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF-www.fshf.org.

5. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrjen më të gjërë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF- www.fshf.org.

6. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

7. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjor të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

8. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlersim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.

9. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlersim paraprak të metodologjisë pranë Autoritetit të Konkurrencës.

10. Detyrimet e përcaktuara në pika 3, 4, 5, 6, 7, 9 duhet të përmbushen brenda afatit 120 ditore nga dita që ky vendim i është njoftuar.

11. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5% të xhiros mesatare ditore për shkelje të rënda të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr.9121/2003.

12. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 2 vjeçare.

13. Ngarkohet Sekretariati i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e palës së paditur, pala paditëse Federata Shqipëtare e Futbollit, i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës duke kërkuar sipas objektit.

- **Pretendimet e palëve:**

Paditësi:

Në parashtrimet e paraqitura në kërkesëpadi, si dhe ato të paraqitura gjatë gjykimit, nga pala paditëse në mënyrë të përmbledhur u pretendua si më poshtë:

1. Vendimi përfundimtar i Komisionit, objekt i këtij gjykimi, pasqyron në përmbajtjen e tij një mungesë të theksuar arsytimi si dhe bazueshmërie ligjore por njëkohësisht edhe referenca tërësisht teorike, pa asnjë bazë konkrete të konkluzioneve që i padituri nxjerr. Konkretisht në pikën 14 të vendimit Komisioni shprehet se për sa i përket tregut përkatës të produktit, në rastin konkret nuk kemi ndërmarrje të tjera të cilat të plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si konkurrentë, pasi është e vetme FSHF. Sipas të paditurit e drejta e transmetimit audioviziv është dhënë ekskluzivisht dhe konsumatorët nuk mund të këmbëjnë produktet me ato të tregut përkatës, në përgjigje të ndryshimit të çmimeve. Ky konkluzion i Komisionit nuk shoqërohet me ndonjë referencë ligjore dhe as nuk shpjegohet më tej prej tij se për cilat produkte në treg mund të mundësohej këmbimi? A ka produkte të tjera në këtë treg, në kushtet kur produkti i vetëm për shkak të ligjit nr.79/2017 "Për sportin" është ai i mundësuar nga FSHF dhe askush tjetër përveç paditësit nuk mund të vendosë në treg një produkt të tillë?

2. Në pikën 16, vendimi shfaq një tjetër trajtim dhe konkluzion teorik, të pa shoqëruar me asnjë element provues apo bazueshmëri ligjore, konkretisht: "Kështu edhe pse shet në Kosovë FSHF, kjo zonë dallohet nga parapëlqimet e konsumatorëve, rëndësia e preferencave kombëtare, informacioni mbi variacionet e çmimeve dhe të shitjeve sipas zonës, sa ju kushton klientëve për të kërkuar produktet që furnizohen nga zona të tjera gjeografike, diferencat e çmimeve në nivel kombëtar, si dhe nëse klientët e palëve zhvendosin porositë e tyre drejt ndërmarrjeve të vendosura diku tjetër në një periudhë afatshkurtër dhe me një kosto të pakonsiderueshme". Ku bazohet ky përshkrim dhe cilësim i Komisionit për zonën e Kosovës? Si janë konstatuar nga Komisioni, parapëlqimet e konsumatorëve, rëndësia e preferencave kombëtare, diferencat e çmimeve në nivel kombëtar etj.

3. Në referim të ligjit "Për sportin", neni 35 "Të drejtat e transmetimit" parashikon se organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me konkurrim publik. Në lidhje me shitjen e të drejtës televizive, vendimi ka cilësuar në pikën 35 të tij, shitjen nga FSHF të së drejtës televizive për "Kategorinë Superiore" dhe "Kupa e Shqipërisë", brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 3-vjeçare në vitet 2015-2018, dhe për një periudhë 4-vjeçare për periudhën 2018-

2022. Pavarisht se kemi të bëjmë me dy periudha të ndryshme, të ndara nga njëra-tjetra, prej 3 (tre) dhe (4) vitesh të cilat janë materializuar po kaq të veçanta nga njëra-tjetëra, në procedura dhe kontrata të ndryshme, bazuar mbi procedura të qarta, publike dhe transparente konkurrimi e ofertash, Komisioni në vendimarrjen e tij e trajton si një periudhë ekskluziviteti 7-vjeçar, duke dhënë përshtypjen e cenimit të konkurrencës apo të abuzimit nga FSHF me pozitën dominuese.

4. Në pikën 41 të vendimit Komisioni arsyeton se: “Kontrata e licencimit e dhënë për 3 dhe 4 vjet (të njëjtit operator) bie në kundërshtim me praktikat ndërkombëtare”. I paditur, nuk argumenton këtë konkluzion si me cilat praktika ndërkombëtare bie në kundërshtim licencimi i dhënë për 3 dhe 4 vite. Referimi i bërë në vendim tek Vendimi i Komisionit Evropian për Konkurrencën i datës 19.01.2005, për rastin e shitjes së përbashkët të të drejtave televizive të Bundesligës Gjermane (kampionati gjerman i futbollit), nuk mund të krijonte shqetësimin dhe bindjen e Komisionit për shitjen e të drejtave tek i njëjti operator dhe në kohëzgjatjen konkrete (3 dhe 4 vjet). Në atë vendimarrje, Komisioni Evropian ka pranuar angazhimet e Ligës Gjermane të Futbollit për reduktimin e qëllimit dhe të kohëzgjatjes së marrëveshjeve të ardhshme, duke zbatuar një procedurë marketingu transparente dhe jo diskriminuese. Ndërsa vendimarrja e të paditurit në rastin konkret shkon përtej konstatimeve dhe vendimarrjes së Komisionit Evropian mbi Konkurrencën, teksa pretendon për ekzistencën e 2 (dy) tregjeve, pa i specifikuar ato se cilat janë.

5. Në pikën 45 të vendimit, Komisioni pranon faktin se FSHF zotëron të drejtat televizive të të gjitha ndeshjeve të Kombëtares Shqiptare dhe nga ana tjetër FSHF dhe klubet pjesëmarrëse kanë rënë formalisht dakord për centralizimin e shitjes së të drejtave televizive të Ligës Shqipëtare të Futbollit, duke rënë po ashtu dakord se janë pjesë e një skeme të të ardhurave të gjeneruara. Në pikën 46 të vendimit, Komisioni shprehet se: “Zbatimi i ligjit për konkurrencën për të drejtën audiovizive lidhet kryesisht me shitjen kolektive/përbashkët, të së drejtës së transmetimit dhe të mbulimit të eventeve sportive. Shitja kolektive, pa praninë e palës së tretë kufizon konkurrencën në dy mënyra: (i) Dhënia e një fuqie të tregut Federatës për të përcaktuar çmimin e të drejtave audiovizuale, që çon në çmime të fryera si në rrjedhën e sipërme për transmetuesit, ashtu edhe në rrjedhjen e poshtme për konsumatorët; (ii) Forcimi i pozitës së tregut të transmetuesve në tregun e rrjedhjes së poshtme, pasi ata mund të jenë operatorët e vetëm në gjendje të ofrojnë të gjitha të drejtat në një paketë”. I padituri, nuk argumenton në këtë konkluzion se cila është “pala e tretë” e cila nuk paska qenë e pranishme dhe si prania e saj do të lejonte konkurrencën? Po shitjet kolektive, do ta ndalonte pjesëmarrjen e “palës së tretë”? Në cilën dispozitë ligjore bazohet për këtë konkluzion? Si e përcakton FSHF çmimin e të drejtave audiovizuale, nëse kontratat për dhënien e këtyre të drejtave është rezultat i një procedure konkurrimi dhe ofertash publike, nga të gjithë

operatorët e interesuar në treg, prej të cilëve përzgjidhet çmimi më i mirë dhe më fitimprurës për organizatën dhe anëtarët e saj.

6. Në lidhje me konkluzionin se afati 3 (tre) vjeçar është një praktikë më e përhapur se rasti konkret i kontratës 4 (katër) vjeçare, gjykojmë se kjo kurrsesi nuk mund të jetë detyruese për palët. Raporti i të paditurit ka konkluduar se Komisioni Evropian për Konkurrencën, afatin 3 (tre) vjeçar e konsideron si më të pranueshmin, por kjo nuk është absolute, pasi duhen marrë parasysh faktorët si situata e tregut, pozita e palëve kontraktuese, qëllimi dhe natyra e këtyre të drejtave. FSHF ka theksuar vazhdimisht se ky afat i është ofruar njësoj të gjithë operatorëve, pa dallim. Praktika e referuar nga Komisioni, jo domosdoshmërisht përputhen me realitetin e tregut audio vizual shqiptar. Gjithashtu, afati lidhte me mandatin 4 (katër) vjeçar të zgjedhjes së Komitetit Ekzekutiv të FSHF dhe së treti lidhet edhe me amortizimin e kostove të prodhimit nga operatorët fitues. Është e pakuptimtë të akuzohet FSHF për abuzim me pozitën dominuese dhe gjykojmë se neni 9 i ligjit të Konkurrencës nuk mund të aplikohet pasi vetë struktura e zhvillimit të aktiviteteve sportive, Kampionat apo Kupa e Republikës, shërben për të nxitur konkurrencën sportive dhe tregtare midis klubeve dhe jo për ta kufizuar atë. Pikërisht modeli i aplikuar, i miratuar nga vetë anëtarësia e FSHF, ndihmon në një balancë ndërmjet klubeve e inkurajon angazhimin e lojtarëve të rinj të cilët nxisin konkurrencën në futboll.

7. Anëtarët e FSHF kanë pavarësi të konkurrojnë në fushën e sponsorizimeve, reklamave në stadione, për shit-blerjen e lojtarëve, por dhe janë në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesëmarrës e faktorë në vendimarrje për shitje të drejtash televizive, duke i ushtruar këto kompetenca të tyre nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së votës në organet vendimarrëse. Rishpërndarja e të ardhurave në masën dhe formën që vetë anëtarësia ka përcaktuar, shërben pikërisht për të zgjeruar bazën e konkurrencës. Shitja nëpërmjet një pike të vetme ka një rëndësi të veçantë, pasi shërben si një parakusht për ekzistencën e kampionatit dhe kupës. Kështu, para fillimit të sezonit asnjë klub i veçantë nuk e di se deri ku do të pozicionohet dhe rrjedhimisht nuk mund të nënshkruajë një kontratë me një operator televiziv, pasi për çdo operator televiziv kjo përbën një element pasigurie. Shitja nga një pikë e vetme i mundëson sponsorëve televizivë të marrin një paketë të tërë uniforme për të gjithë kohëzgjatje e kampionatit apo kupës dhe nga ana tjetër iu garanton klubeve ekspozim në media përgjatë gjithë aktivitetit, duke iu mundësuar në këtë mënyrë strukturimin më të mirë e buxheteve të tyre të reklamave duke shmangur që disa ndeshje të mos transmetohen. Ky model është miratuar nga vetë anëtarësia e FSHF e cila ka bindjen e plotë që kjo mundëson konkurrencën edhe për klubet më të vogla. Ky model garanton dhe marrjen e “Highlights” në një pikë të vetme, ç’ka i bën këto të fundit më të aksesueshëm edhe nga publiku i gjërë dhe në një kohë më të shpejtë. Praktika e FSHF është në përputhje me vendimin e Komisionit Evropian, për rastin e shitjes së përbashkët të të drejtave komerciale të Champions League. Sipas vendimit në fjalë,

prodhimi dhe shpërndarja e përbashkët e produktit ka rritur cilësinë e brandit duke e fokusuar në një pikë të vetme të shitjes. Vendimi i Këshillit arrin në konkluzionin se shitja e përbashkët e të drejtave televizive të UEFA Champions League nga UEFA, nuk e ka eliminuar konkurrencën. Praktika e shitjes të një transmetuesi i vetëm nuk diktohet nga FSHF por nga transmetuesit audiovizualë, të cilët në të gjitha praktikatat kërkojnë ekskluzivitetin për çmimin e paguar për transmetimin e aktiviteteve sportive dhe tashme kjo është një praktikë e konsoliduar nëpërmjet Komisionit Evropian dhe EBU, ku p.sh. Federata Franceze e Futbollit, siguron ekskluzivitetin e kontratave për transmetime ekskluzive për periudha jo më të gjata se 5-vjeçare. I paditur pretendon se shitja bashkë e dy kompeticioneve (kampionat dhe kupa e Shqipërisë) përbën formë të abuzimit me pozitën dominuese që FSHF ka në kuptim të nenit 9, pika 2 të Ligjit nr.9121/2003. Por Komisioni Evropian i Konkurrencës, praktikës së të cilës i referohet i padituri, nuk ka vendosur ndonjë detyrim të tillë për shitjen e paketave televizive të ndara në kompeticione; kampionat dhe kupë.

8. Për sa i përket sponsorizimeve ligji nuk parashikon asnjë procedurë, garë apo formalitet tjetër, përveç shprehjes së vullnetit të përbashkët dhe marrëveshjeve midis palëve. Nga ana tjetër, sponsorizimet në FSHF janë etërsisht të hapura dhe nuk ka asnjë kufizim, pra janë në përputhje të plotë me ligjin. I padituri nuk ka konstatuar dhe as nuk ka pasur ndonjë ankesë nga sponsorë potencialë të cilët të jenë penguar apo të jenë kufizuar në dëshirën e tyre për të qenë sponsorë të FSHF apo të ekipit kombëtar. Në pikën 64 të vendimit, Komisioni konstaton lidhjen midis sponsorëve të FSHF dhe pjesëmarrjes së tyre në të drejta pasurore në kompaninë DIGITALB. Në këtë pikë, abuzimi i trajtimit të çështjes nga i padituri është evident, teksa analizon subjekte, persona juridik dhe individ të cilët nuk janë aspak objekt i hetimit dhe as nuk kanë dijeni për këtë hetim dhe implikimin e tyre në një vendimarrje të Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë rast, i padituri ka marrë një vendim mbi fakte dhe rrethana, të cilat as nuk janë trajtuar më parë dhe as nuk janë bërë me dije FSHF, duke cënuar rëndë granancitë procedurale, siç është e drejta për t'u dëgjuar. Komisioni, nuk ka trajtuar në raportin e hetimit të thelluar ndaj FSHF këtë çështje. Nga kjo vendimarrje e palës së paditur, janë cënuar padrejtësisht interesat e FSHF, të cilës nuk i është mundësuar në asnjë rast mundësia për t'u shprehur, për të paraqitur prova në lidhje me këtë çështje të patrajtuar më parë nga i padituri.

9. Vendimarrja e Komisionit është gjithashtu e pa bazuar në referimin dhe kërkesat për Ligën Profesioniste, ekzistencën e saj dhe pjesëmarrjen në negocimin dhe shitjen e të drejtës televizive apo në transparencën e shpërndarjes së fondeve/investimeve ndërmjet klubeve. Liga profesioniste është krijuar vetëm në vitin 2019, dhe nuk ka ekzistuar më parë, duke qenë e pamundur pjesëmarrja e saj në cilido negociim të mëparshëm. Por, ç'ka është më e rëndësishme, klubet anëtare të FSHF, ashtu siç pohon dhe vetë Komisioni, kanë deleguar dhe autorizuar Federatën të negociojë dhe shesë të drejtat televizive, në emër të tyre, e

sanksionuar kjo në aktin themeltar të FSHF (Statusin e saj). Të gjitha klubet anëtare miratojnë në mënyrë të përvitshme bilancin dhe pasqyrat financiare të FSHF, duke miratuar edhe të ardhurat dhe shpenzimet e saj për vitin paraardhës. Komisioni nuk paraqet asnjë bazë konkrete ligjore se nga buron detyrimi për të përfshirë një palë të tretë tanimë, pa një status juridik dhe si do të ndikonte përfshirja e saj në kufizimin e pozitës dominuese.

10. Në lidhje me çeshtjen e biletave të ekipit kombëtar dhe çmimit të aplikuar nga FSHF, Komisioni dukshëm nuk ka shqyrtuar komentet përfundimtare dhe angazhimet e FSHF të dërguar me shkresën e datës 06.02.2020, por insiston në klasifikimin e çmimit të biletave me ato të vendeve të tjera, veprim ky i cili arrin në konkluzionin e gabuar se mungesa e metodologjisë në përcaktimin e çmimit të biletave nga FSHF, ka shkaktuar caktimin e çmimeve të larta, çka përbën abuzim me pozitën dominuese. Lidhur me konkluzionet e raportit hetimor për çmimin e biletave FSHF ka qenë transparente, duke ofruar të gjithë informacionet e nevojshme për Autoritetin e Konkurrencës dhe ka shprehur angazhimin që në rezultatet paraprake të hetimit për miratimin e nje metodologjie.

Pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit:

Nëpërmjet prapësimeve të paraqitura gjatë gjykimit, pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur u prapësuan kërkimet e palës paditëse si më poshtë:

1. Pala paditëse në pretendimet e ngritura në kërkesë padi është konfuze dhe e paqartë në kërkimet e saj dhe në faktet që kërkon të mbështesë këto pretendime. Pala paditëse pretendon që vendimi të jetë mbështetur në referenca teorike, ndërkohë që praktikrat e cituara në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.639, datë 14.05.2020, janë pjesë e praktikave më të mira dhe më të sukseshme të aplikuara si nga Institucionet homologe të vendeve që janë anëtare kryesore të BE, ashtu dhe të praktikave të Komisionit Evropian. Të njejtën paqartësi pala paditëse e ka dhe me konceptin e monitorimit që kryen Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet Sekretariatit, siç e parashikohet në nenin 28/a të Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

2. Pala paditëse i pranon si të sakta konstatimet e bëra në vendim për pjesën që ajo ka një pozitë dominuese për shkak të ligjit nr.97/2017 “Për sportin”, i cili përcakton palën paditëse si i vetmi entitet që shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive dhe është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë sportive me konkurim publik. Asnjë nga kompetencat që FSHF ka, nuk mund të ushtrohen nga asnjë person juridik privat ose publik. Nga këto del qartë pozita dominuese që pala paditëse ka dhe për rrjedhojë detyrimet që i rrjedhin nga Ligji nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Nuk ndalohet pasja e një pozite dominuese sipas nenit 8, por është e ndaluar abuzimi me këtë pozitë, sipas nenit 9 i ligjit, dhe kjo është baza ligjore e hetimit të kryer nga Autoriteti.

3. Komisioni i Konkurrencës në vendimin e tij është mbështetur në metodologjitë dhe materialet e përdorura nga OECD, UNCTAD, Vendimet e Komisionit Evropian për Konkurrencën dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në këto vlersime referohet për afatet maksimale 3 vjeçare për dhënien e të drejtave ekskluzive, gjithmon duke mbajtur parasysh edhe mundësinë e shmangies së ekskluzivitetit në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive. Ky afat është caktuar në bazë të analizave të përgjithshme për këtë sport dhe natyrën e veçantë të këtyre të drejtave. Kjo është marrë në konsideratë për shitjen ekskluzive të vetëm një kompeticioni dhe jo Kampionatit dhe Kupës të shitura së bashku, pasi në praktikën e këtyre vendeve shitja e këtyre të drejtave të dy kompeticioneve së bashku duhet bërë duke kërkuar përjashtimin nga marrëveshja në përputhje me ligjin nr.9121/2003. Gjendja faktike është se të dy kompeticionet janë shitur në mënyrë ekskluzive një operatori dhe mbi këtë bazë i janë dhënë dhe detyrimet për t'u përmbushur nga pala paditëse.

4. Kontratat e lidhura nga FSHF për shitjen e të drejtave ekskluzive pavarësisht se janë lidhur me dy kontrata, e para me afat 3 vjeçar 2015-2018, dhe e dyta me afat 4 vjeçar 2018-2022, ato rezultojnë me ekskluzivitetin në treg të vetëm një ndërmarrje që përfiton nga këto të drejta ekskluzive dhe përjashtimin e të gjithë operatorëve të tjerë nga transmetimi i këtyre kompeticioneve për një afat 7 vjeçar. Pasojat në këtë treg janë të rënda për shkak të ekskluzivitetit duke krijuar monopol në tregun e transmetimit të këtyre veprimtarive sportive, pasi është vetëm një operator që i transmeton për një afat 7 vjeçar. Përjashtimi i ndërmarrjeve të tjera nga mundësia për të marrë pjesë në transmetim për një afat 7 vjeçar, përbën kufizim të konkurrencës, nëpërmjet abuzimit me pozitën dominuese që pala paditëse ka. Shitja e të drejtave ekskluzive në të dy kontratat është dhënë për të dy kompeticionet “Kategoria Superiore” (kampionat) dhe për “Kupën e Shqipërisë”, duke përjashtuar ndërmarrjet e tjera të interesuara në të dy kompeticionet që organizon pala paditëse për një afat 7 vjeçar.

5. Pala paditës është e paqartë në vetë kuptimin e shitjes së drejtës kolektive të drejtave televizive. Pala paditëse referon tek pronësia e të drejtave televizive si një e drejtë absolute në raport me palët e tjera që janë pjesë e këtyre të drejtave, siç janë klubet pjesmarrëse në kompeticion dhe pa të cilat logjikisht nuk do të kishte kompeticione. Pala paditëse, pavarësisht se përfiton nga këto të drejta që rrjedhin nga pjesmarrja e klubeve sportive, i ka vendos ato në një pozitë inekzistente në raport me shitjen e këtyre të drejtave dhe në kontrollin e negocimit të shitjes së këtyre të drejtave. Ekskluziviteti që merr ndërmarrja për transmetimin e këtyre kompeticioneve është i një natyre përjashtuese për ndërmarrjet e tjera që transmetojnë këto kompeticione në tregun audioviziv duke e vendos ndërmarrjen që përfiton këto të drejta në pozitën e operatorit të vetëm që transmeton kompeticionet e

futbollit në vend. Prandaj del qartë se palët e treta që janë të interesuara në shitjen e këtyre të drejtave janë si klubet e futbollit ashtu dhe transmetuesit audioviziv. Pala paditëse pretendon se është zhvilluar një garë në shitjen e këtyre të drejtave, por faktikisht ka rezultuar me shitjen e të drejtave ekskluzive dhe vetëm nja operatori për të dy kompeticionet që ka organizuar pala paditëse për një afat 7 vjeçar. Në këtë treg, nuk është krijuar mundësia për pjesmarrje të ndërmarrjeve të tjera që operojnë në këtë treg qoftë për vetëm një nga dy kompeticionet. Kjo ka sjellë cenim të konkurrencës duke dhënë ekskluzivitet dhe përjashtim të ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg duke i dhënë ekskluzivitetin vetëm një ndërmarrje. Shitja e përbashkët të të drejtave televizive mund të bëhet nga pala paditëse, por në negociimin e këtyre të drejtave duhet të kenë një rol aktiv edhe klubet që janë pjesë e këtyre të drejtave dhe në mënyrë direkte apo indirekte i preken këto interesa, pasi janë po këto klube që konkurrojnë në nivel sportiv dhe financiar me njëri tjetrin. Roli aktiv i tyre e rrit transparencën dhe e bën efektive dhe negociimin e këtyre të drejtave. Klubet sportive janë subjekte juridike të ndara nga FSHF, pavarësisht se janë anëtarë. Për shitjen e të drejtave televizive të përbashkëta për dy kompeticione të ndryshme në vendet e BE është ndjek rruga e kërimit për përjashtim të marrëveshjes sipas nenit 5 të Ligjit nr.9121/2003, tek Autoriteti i Konkurrencës, dhe shitja e këtyre kompeticioneve së bashku nuk është parë në mënyrë favorizuese. Ky qëndrim është në përputhje të plotë me nenin 101/3 të TFBE.

6. Paditësi pretendon se praktika e shitjes tek një transmetues i vetëm nuk diktohet nga FSHF, por nga transmetuesit audioviziv, ndërkohë që këtë të drejtë të dhënë nga ligji dhe të pranuar nga vetë pala paditëse e ka vetë ajo. Pala paditëse nuk e fakton më asnjë analizë të bërë nga ana e saj se pse ky negociim i bërë nga ana e saj pavarësisht pretendimit se i është ofruar disa palëve pa përfunduar me shitjen e kësaj të drejte vetëm një operatori dhe në mënyrë ekskluzive me një afat prej 7 vitesh. Duke qenë se vetë pala paditëse e ka të drejtën e shitjes së të drejtave televizive të kompeticioneve që organizon është ajo që dikton dhe mënyrën se si bëhen ofertat operatorëve dhe mënyrën e shitjes së tyre. Pala paditëse nuk mund të justifikohet me pretendimin se është transmetuesi ai që vendos konditat e një negociimi kur ai nuk ka asnjë siguri që mund t'i përfitoj këto të drejta. Nuk mundet që pala paditëse të justifikohet që procedura dhe negociimi të jenë të rregullta pasi nuk ka pas asnjë ankesë nga asnjë operator. Vetë pozita që ka FSHF e vendos në pozitë të vështirë çdo ndërmarrje apo edhe klub sportiv që do dëshironte të mbronte interesin e tij nëpërmjet ankimit pranë vetë palës paditëse.

7. Ndarja që i ka bërë pala paditëse të dy kompeticioneve me paketën A dhe B, ku paketa A janë ndeshjet e rëndësishme dhe paketa B janë ndeshjet e tjera, është një ndarje që vetë synon shitjen e të drejtave televizive për të dy kompeticionet automatikisht, pa dhënë asnjë justifikim apo analizë ekonomike pse kjo ndarje është parë e arsyeshme apo është më efektive në negociimin e ofertave nga operatorët që janë të interesuar. Përkundrazi kjo ndarje

që shtë menduar nga pala paditëse përjashton mundësinë e ndërmarrjeve të interesuara që të marrin pjesë në të paktën një nga këto dy kompeticione dhe për negociimin e të drejtave televizive ekskluzive e kanalizon ofertën që të jetë e përfshirë automatikisht për dy kompeticione, duke krijuar mundësinë që të ekzistoj vetëm një operator në këte treg dhe duke përjashtuar çdo operator të mundshëm që do të ishte i interesuar për të marrë pjesë dhe të konkuronte me operatorin tjetër.

8. Lidhur me sponsorizimet pala paditëse pretendon se deri sa ligji për sportin nuk parashikon ndonjë garë apo procedurë të caktuar ajo është e lirë të veprojë pa u kontrolluar nga ligji nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar. Pasja e një pozite dominuese të palës paditëse nuk është endaluar nga ligji, por e ngarkon atë me detyrime që të mos të çenojë këtë pozitë që ajo ka. Paditësi duhet të realizojë një procedurë e cila duhet të jetë transparente për të gjithë subjektet që janë të interesuara të jenë pjesë e sponsorizimeve për marketimin e aktiviteteve të tyre. E drejta e sponsorve lidhet dhe me përjashtimin e sponsorve që janë apo mund të jenë konkurrentë në tregun e tyre përkatës. Një procedurë transparente dhe publike ku të gjithë subjektet e interesuara mund të marrin pjesë i jep mundësinë që sponsorët të zgjidhen sipas një procedure pa përjashtuar konkurrentët për të marrë pjesë apo garuar për sponsorizime. Lidhjet e drejtpërdrejta apo të tërthorta të interesave pasurore të përfaqësuesve ligjorë të FSHF me ortakët e DIGITALB apo sponsorët, kanë sjellë shtrembërim dhe kufizim të konkurrencës. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet vendimit nr.693, datë 14.05.2020, ka dhënë detyrimin për shmangien e lidhjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të interesave pasurore, të cilat kufizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë konkurrencën në treg, si dhe influencojnë vijueshmërinë e kësaj kontrate.

9. Lidhur me shpërndarjen e fondeve të ardhurave me destinacione të përcaktuara nga UEFA, FIFA etj, nga FSHF ka mungesë të plotë informacioni, transparence dhe nevojash për përdorimin e këtyre fondeve kundrejt klubeve të futbollit. FSHF thjesht pasqyron këtë fond si shpenzim në bilancin e saj vjetor, pa specifikuar qëllimin dhe destinacionin e këtij fondi. Pala paditëse nuk mund të justifikohet me informimin dhe bilancet vjetore që bëhen publike, ndërkohë nuk ka asnjë informacion mbi këto fonde dhe përdorimin e tyre. Për këtë arsye merr rëndësi pania e Ligës Profesioniste, ku Presidentët e klubeve pjesmarrëse në kompeticion si përfaqësues ligjor të klubeve të futbollit duhet të paraqesin nevojat dhe domosdoshmëritë e tyre për marrjen dhe përdorimin e këtyre fondeve sipas një destinacioni të mirë përcaktuar. Pala paditëse justifikohet me pretendimin se klubet ja kanë deleguar dhe autorizuar FSHF-së që të negociojë dhe të shesë të drejtat e tyre televizive, por kjo duhet bërë pa ju shmangur dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo e drejtë e cila prek interesat e po këtyre klubeve që e kanë autorizuar. Pjesmarrja aktive e Ligës Profesioniste që përbëhet nga

vetë klubet jep mundësinë klubeve për mbrojtjen sa më të mirë të interesave të tyre në procesin e shitjes së të drejtave televizive dhe të drejtave që rrjedhin nga ajo.

10. Për çmimin e biletave pala paditëse nuk ka një metodologji për nxjerrjen e çmimit, duke e lënë në mënyrë abuzive caktimin e tij. Në mungesë të dhënave të kërkuara pala paditëse është bërë benchmark (metodë analize krahasuese) për çmimet e biletave me vendet e rajonit që kanë një nivel të përafërt ose të njejtë ekonomik me vendin tonë. Konkluzionet e dala janë që çmimet e biletave janë më të larta në rajon dhe pala paditëse nuk kishte asnjë analizë ekonomike për këtë. Pala paditëse ka pozitë dominuese dhe është e detyruar që të hartojë një metodologji për caktimin e çmimit të biletave, në mënyrë që ky çmim të mos jetë abuziv por të jetë i orientuar drejt kostos. Nuk është justifikim për palën paditëse fakti i ndërtimit të stadiumeve apo investimeve të tjera, për mos të bërë një analizë ekonomike se sa është ky ndikim në çmimin e biletës apo të faktorëve të tjerë, por caktimi i çmimit të lihet në mënyrë abuzive. Detyrimet e dhëna nëpërmjet Vendimit nr.693, datë 14.05.2020 i kërkojnë FSHF të ndalojë abuzimin m epozitën dominuese në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik për të ardhmen, si dhe të respektojë rregullat e konkurrencës.

- **Vlersimi i gjykatës:**

Në lidhje me plotësimin e kushteve formale të padisë:

Një nga kushtet formale të paraqitjes së padisë në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është ajo e ezaurimit të rrugës administrative të ankimit, si dhe ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

Sipas **nenit 129 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH"**, ligj ky që ishte në fuqi në kohën e nxjerrjes së aktit administrativ, objekt gjykimi "Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur"

- a) ligji nuk ka parashikuar organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;
- b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t`u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë;
- c) organi më i lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cënuar, me vendimin e tij të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.

Po ashtu, i njëjti parashikim ligjor, është parashikuar edhe në ligjin e posaçëm **nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"** i ndryshuar,

i cili në nenin 16 pika 1 të tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykatës.

Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) *ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;*

b) *ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;*

c) *organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personalë të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.*

Në lidhje me shterimin ose jo të ankimit administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.1 datë 26.11.2010, kanë arritur në përfundimin unifikues sipas të cilit: **"Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhënien juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ"**.

Ligji organik nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" i ndryshuar, i cili rregullon veprimtarinë administrative dhe juridike në fushën e mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, dhe që gjendet i zbatueshëm në çështjen në gjykim, në **nenin 79 të tij** ka parashikuar se: **"Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin."**

Nga përmbajtja e kësaj dispozite shihet qartë se kemi një shmangie nga parimi i përgjithshëm i ezaurimit të rekursit administrativ, dhe se në rastin konkret palët mund t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës pa qenë e nevojshme që të konsumojnë rrugën e ankimit administrativ.

Në këto kushte, paditësi ka të drejtë që t'i drejtohet direkt gjykatës nëpërmjet padisë si mjet i vetëm procedural, nëpërmjet të cilës të mund të rivendosë në vend të drejtat e tij, të pretenduara si të shkelura nga pala e paditur. *Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta*

shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi (neni 31 i K.Pr.Civile).

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 129, germa "b" të K.Pr.Administrative, si dhe nenit 16, pika 2, germa "a" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrativ" i ndryshuar, paditësi legjitimohet për tju drejtuar drejtpërdrejt gjykatës me padi për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së tij të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur, dh se çeshtja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësorë.

Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë:

Ashtu siç u citua më sipër, kusht tjetër formal për paraqitjen e padisë, është ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

Në nenin 18 pika 1 të Ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, (Afati për ngritjen e padisë) thuhet se:

1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve.

Ky afat fillon nga:

a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;

Në lidhje me afatet e parashkrimit legjislacioni ynë parashikon dy kategori të afateve të parashkrimit; **afate të përgjithshme dhe afate të posaçme**, ku afatet e përgjithshme janë më të gjata se afatet e posaçme.

Afatet e përgjithshme të parashkrimit zbatohen për të gjitha kërkesat që i shtrohen parashkrimit shues, kur për këto nuk është caktuar në ligj një afat i posaçëm parashkrimi.

Ashtu siç u citua më sipër, afati i përgjithshëm i ngritjes së padisë për të kundërshtuar një akt administrativ, sipas nenit 18, pika 1 të ligjit nr. 49/2012, është 45 ditë, afat ky që fillon nga data e njoftimit të aktit.

Ndërkohë, në ligjin e posaçëm nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" i ndryshuar, në nenin 79 të tij parashikohet: **"Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin."**

Rezulton se Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës Nr. 693, datë 14.05.2020, i është njoftaur palës paditëse me shkresën nr.55/22 prot., datë 15.05.2020, ndërsa padia është depozituar në gjykatë në datën **16.06.2020**, pra brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga dispozita e sipërcituar.

Sa më sipër, gjykata konstaton se padia e paraqitur nga pala paditëse plotëson kushtet formale për t'u marrë në shqyrtim nga ana e gjykatës.

Në lidhje me legjitimimin e palëve:

Sipas nenit 32/a të K.Pr.Civile, padia mund të ngrihet:

a) *për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.*

Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Kështu, sipas nenit 15 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

a) *çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;*

Në kuptim të këtyre dispozitave procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (**legjitimim aktiv**) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mohon ose shkel të drejtën e kërkuarit (**legjitimim pasiv**).

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave procedurale del se personi fizik apo juridik mund të kërkojnë zgjidhjen e konfliktit administrativ nëse plotësohen apo përmbushen dy kushte:

Së pari; akti administrative duhet të jetë i paligjshëm.

Së dyti; paditësi të jetë cënuar në interesat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr. 49/2012, e kondicionon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejtë të mohuar ose të cënuar prej dikujt tjetër.

Referuar provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore rezulton se me aktin administrativ objekt gjykimi, Vendimin Nr. 693, datë 14.05.2020 të Komisionit të Konkurrencës është vendosur:

1. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF si entitet të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv; shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama.

2. Dhenien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF.

a. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprim dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t'u shiten operatorëve të ndryshëm.

b. Detyrimin e FSHF në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive "Kategorinë Superiore" dhe "Kupën e Shqipërisë", me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesmarrje sa më të gjërë për operatorët audioviziv.

c) Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive "Highlighte" dhe krijimin e mundësive për pjesmarrje sa më të gjërë për operatorët audioviziv.

3. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimarrje, që ka të bëjë me "shitjen e përbashkët të së drejtës televizive", si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.

4. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF-www.fshf.org.

5. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesmarrjen më të gjërë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF- www.fshf.org.

6. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

7. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjor të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

8. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlersim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.

9. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlersim paraprak të metodologjisë pranë Autoritetit të Konkurrencës.

10. Detyrimet e përcaktuara në pika 3, 4, 5, 6, 7, 9 duhet të përmbushen brenda afatit 120 ditë nga dita që ky vendim i është njoftuar.

11. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5% të xhiros mesatare ditore për shkelje të rënda të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr.9121/2003.

12. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 2 vjeçare.

Sa më sipër, bazuar në nenin 32/a të K.Pr.Civile, si nenit 15/a të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, pala paditëse legjitimohet për tju drejtuar me padi gjykatës për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së tij të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur, pasi akti administrativ i

sipërcituar ka cënuar drejtpërdrejt interesat e tij pasurore dhe ato që lidhen me ushtrimin e aktivitetit tregtar.

Po ashtu, pala e paditur Autoriteti i Konkurrencës ka legjitimitet pasiv në këtë gjykim, pasi akti i sipërcituar objekt gjykimi, është nxjerrë nga ky organ.

Nga sa më sipër, si paditësi ashtu dhe pala e paditur, kanë legjitimitet aktiv dhe pasiv në këtë gjykim.

Në lidhje me themelin e çeshtjes:

Në lidhje me sa u pretendua nga ana e palëve në këtë gjykim, Gjykata, referuar rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore si dhe shkakut ligjor të padisë, çmon se kërkimet e palës paditëse janë të pa bazuara në ligj dhe në prova, dhe se kërkesëpadia e paraqitur prej saj duhet rrëzuar, duke arsyetuar si më poshtë:

Në vlersimin në tërësi të çeshtjes, nga ana e gjykatës shtrohen për zgjidhje këto çeshtje:

- 1) Nëse ndërmarrja (*Federata Shqiptare e Futbollit*), ka pozitë dominuese në referim të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “*Për mbrojtjen e konkurrencës*” të ndryshuar, dhe;
- 2) Nëse po a ka abuzim me pozitën dominuese në treg.

- **Analiza e konkurrencës:**

Sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 7 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “*Për mbrojtjen e konkurrencës*” të ndryshuar, **“Tregu përkatës”** janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.”

Në kuptim të dispozitës ligjore të sipërcituar **“tregu përkatës”** përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.

Tregu përkatës i produktit.

Në rastin konkret, nuk kemi ndërmarrje të tjera që plotësojnë kushtet për t’u konsideruar si konkurrentë ekzistues, pasi FSHF është e vetme. Në tregjet e shërbimeve e drejta e

transmetimit audioviziv i është dhënë ekskluzivisht FSHF, dhe konsumatorët nuk mund të këmbejnë produkte me ato të tregut përkatës, në përgjigje të ndryshimeve të çmimeve.

Bazuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është i gjithë aktiviteti ekonomik i FSHF me produktet/shërbimet që kryhen si: shitja e të drejtës së transmetimit të eventeve sportive në të cilën përfshihen ndeshjet e kategorisë superiore, kategorisë së parë, Kupa e Shqipërisë si dhe ndeshjet e ekipeve Kombëtare; shitja e biletave, sponsorizimet etj.

Tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës gjeografik, përcaktohet si një treg ku përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene dhe që mund të dallohen nga zona fqinje sepse kushtet e konkurrencës janë vlersuar të ndryshme në këto zona. Kështu edhe pse FSHF shet në Kosovë, kjo zonë dallohet nga parapëlqimet e konsumatorëve, rëndësia e preferencave kombëtare, informacioni mbi varacionet e çmimeve dhe të shitjes sipas zonës, sa ju kushton klientëve për të kërkuar produktet që furnizohen nga zona të tjera gjeografike, diferencat e çmimeve në nivel kombëtar si dhe nëse klientët e palëve çvendosin porositë e tyre drejt ndërmarrjeve të vendosura diku tjetër, në një periudhë afat shkurtër dhe me një kosto të pakonsiderueshme.

Sa më sipër, tregu përkatës gjeografik është i gjithë territori i Shqipërisë duke qenë se ky produkt tregtohet në të gjithë territorin me të njëjtat kushte.

- **Në lidhje me vlerësimin e pozitës dominuese:**

Sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 5 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, **“Pozitë dominuese”** është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”

Sipas përcaktimit të bërë në nenin 8 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, pozita dominuese e një ose më shumë ndërmarrjeve vlerësohet, duke marrë parasysh, disa kritere e konkretisht:

a) pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë;

- b) pengesat në hyrje në tregun përkatës;
- c) konkurrencën potenciale;
- ç) fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve;
- d) varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve;
- dh) fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- e) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve;
- ë) lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera;
- f) karakteristika të tjera të tregut përkatës si homogjenitetin e produkteve, transparencën e tregut, uniformitetin e kostos dhe të madhësisë së ndërmarrjeve, qëndrueshmërinë e kërkesës ose të kapaciteteve të lira prodhuese.

Në vlersim të këtyre kriterëve, sa i përket kriterit **“pjesës së tregut”**, Gjykata, konstaton se në bazë të Ligjit nr.97/2017 **“Për sportin”** FSHF është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit. FSHF si organizatore e vetme e veprimtarive sportive është pronare e të drejtës së transmetimit të veprimtarisë futbollistike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurim publik. Parë në këtë aspekt, FSHF ka pozitë dominuese për sa i përket pjesëve të tregut.

Sa i përket kriterit **“konkurrenca potenciale”**, Gjykata konstaton se sipas nenit 18, pika 2 të Ligjit nr.79/2017 **“Për sportin”** asnjë person juridik, privat ose publik, nuk mund të ushtrojë asnjë nga kompetencat ekskluzive të FSHF, vetëm nëse ato i janë dhënë zyrtarisht prej saj. Sa më sipër, FSHF i jepet një status monopol ligjor jo vetëm për organizimin dhe administrimin e aktivitetit të futbollit, por edhe për aktivitetet ekonomike si shitja nga një njësi e vetme që zotëron të drejtat ekskluzive. Parë në këtë kontekst, kjo ndërmarrje (FSHF) nuk ka konkurrentë të tjerë potencial në treg për ofrimin e këtij produkti.

Në lidhje me kriterin e **“pengesat në hyrje në tregun përkatës”** sikurse u citua më sipër, në bazë të Ligjit nr.97/2017 **“Për sportin”** FSHF është entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, konform këtij ligji, dhe se asnjë asnjë person tjetër juridik privat ose publik nuk mund të ushtrojë këtë kompetencë ekskluzive të saj; c’ka tregon se hyrja dhe pengesat janë të larta në tregun përkatës.

Në lidhje me **“fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes”**, pavarësisht se sipas statusit të saj FSHF është një organizatë jofitimprurëse, ajo kryen aktivitet ekonomik dhe gjeneron të ardhura nga shitja e të drejtave të transmetimit televiziv, nga shitja e biletave të ndëshjeve të ekipeve kombëtare, sponsorizime dhe reklama etj, të cilat referuar praktikave të vendeve të

BE, Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Komisionit dhe Gjykatës Komunitare, përfshihet në objektin e Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar. Sipas nenit 48 të statusit të Federatës Shqiptare të Futbollit, të ardhurat e FSHF sigurohen veçanërisht nga; regjistrimet vjetore të anëtarëve dhe kuotat, të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon FSHF, gjobat e vëna nga organet e autorizuara të FSHF, sponsorizimet, donacionet, kontribute, financimet nga shteti, dhe burime të tjera të ligjshme.

Nisur nga këto kritere, Gjykata, çmon se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, FSHF ka pozitë dominuese në tregun e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit.

- **Në lidhje me abuzimin me pozitën dominuese në treg:**

Në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, janë parashikuar rastet të cilët përbëjnë abuzim me pozitën dominuese, në të cilin thuhet se:

Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht:

- a) vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit;
- b) kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
- c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- ç) vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

Sipas hetimit administrativ të realizuar nga Komisioni i Konkurrencës, ka rezultuar se në bazë të parashikimeve të nenit 35 të Ligjit nr.97/2017 “Për sportin”, FSHF i ka shitur DIGITALB të drejtën televizive për “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë” brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për sezonet/periudhën 15.08.2015-15.05.2018 dhe 01.06.2018-01.06.2022.

Në këto kontrata, DIGITALB, ka fituar të drejtën ekskluzive të transmetimit të “Kategorisë Superiore” dhe “Kupës së Shqipërisë”, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në platformën DIGITALB satellit dhe/ose dixhitale tokësorë, PPV, Pay Tv,

Kabllorë, IPTV, OTT, me ose pa pagesë, mobile, internet, duke kryer dhe pagesat përkatëse sipas sezoneve.

Kontratat e licencimit e dhënë për 3 dhe 4 vjet të njejtit operator, çmohet nga Gjykata se bie ndesh me praktikën ndërkombëtare. Kështu, Komisioni Evropian ka përcaktuar disa mjete kundër tejkalimit të të drejtave të kontratave ekskluzive në dy mënyra: (i) të drejtat ekskluzive duhet të reduktohen në fushëveprim, dhe (ii) kohëzgjatjen e ekskluzivitetit.

Në praktikë Liga e Kampioneve të UEFA-s dhe në rastet e Deutscher Fußball-Bund (DFB- (Federata Gjermane e Futbollit) është parë se Komisioni ka pranuar kontrata me kohëzgjatje prej 3 vitesh ku të drejtat janë ndarë dhe u janë shitur operatorëve të ndryshëm.

Ekskluziviteti i një kohëzgjatje më të gjatë dhe për një gamë më të gjërë të të drejtave, mund të kufizojë konkurrencën duke përjashtuar operatorët e tjerë në tregun e rrjedhës së poshtëme, aq më tepër kur kemi të bëjmë me operatorë me pozitë dominuese në të dy tregjet. Gjyqta, vleron se dhënia e ekskluzivitetit absolut në aspektin e fushëveprimit dhe kohëzgjatjes të të drejtës së transmetimit tek një blerës i vetëm siç është DIGITALB, kufizon tregun.

Referuar kontratave të licencimit që FSHF ka nënshkruar me DIGITALB, për të dy sesionet/periudhat, rezulton se të drejtat e transmetimit i janë licencuar DIGITALB mbi baza kolektive, ç'ka nënkupton se sipas termave të kësaj kontrate, licencuesi nuk do t'i japë këto të drejta ndonjë pale të tretë dhe nuk do t'i ushtroje as vetë këto të drejta, deri në përfundimin e kësaj kontrate në asnjë format të njohur transmetimi. Në pikën 3.2 të kontratës 3 vjeçare (15.08.2015-15.05.2018), FSHF parashikonte gjithashtu detyrimin për kalimin e të drejtave ekskluzive, por duke mbajtur të drejtën e të ardhurave prej 50% për kontratat që DIGITALB do të lidh për vendet e tjera Evropiane apo Botërore, duke përfshirë jo vetëm ato televizive, por edhe internet, mobile, platforma "betting" në internet, pra duke vendosur kushte detyruese për palën në kontratë.

FSHF zotëron të drejtat ekskluzive të të gjitha ndeshjeve të Kombëtares Shqiptare. Federata dhe klubet pjesëmarrëse kanë rënë formalisht ndakord që të centralizojnë shitjen e të drejtave televizive të Ligës Shqipëtare të futbollit, dhe gjithashtu kanë rënë dakord që të jenë pjesë e një skeme e të ardhurave të gjeneruara, fakt ky i pohuar dhe nga vetë pala paditëse (FSHF) në këtë gjykim.

Zbatimi i ligjit për konkurrencën për të drejtën audiovizive lidhet kryesisht me shitjen kolektive/përbashkët të së drejtës së transmetimit dhe të mbulimit të eventeve sportive. Shitja kolektive, pa praninë e palës së tretë, kufizon konkurrencën në dy mënyrë kryesore: (i)

Dhënia e një fuqie të tregut Federatës për të përcaktuar çmimin e të drejtave audiovizive, që çon në çmime të fryera si në rrjedhën e sipërme për transmetuesit, ashtu dhe në rrjedhën e poshtëme për konsumatorët; (ii) Forcimi i pozitës së tregut të transmetuesve në tregun e rrjedhës së poshtëme, pasi ata mund të jenë operatorët e vetëm në gjendje të ofrojnë të gjitha të drejtat në një paketë. Komisioni Evropian ka theksuar se shitja e paketave të ndara të të drejtës audiovizive rrit mundësinë për më shumë transmetues, duke përfshirë kompanitë e vogla dhe të mesme për të fituar të drejtën e transmetimeve dhe si rrjedhojë ndikon edhe në favor të konsumatorëve.

Në rastin e Bundesligës Gjermane, Komisioni Evropian i Konkurrencës, ka vënë në dukje se shitja ekskluzive e të drejtave të transmetimit komercial nga Shoqata e Ligës, mund të kufizojë konkurrencën mes klubeve dhe kompanive në divizionin e parë dhe të dytë Gjerman. Në këtë rast u vendosën angazhime për Shoqatën e Ligës për futjen e konkurrencës në marketingun e Bundesligës së parë dhe të dytë, duke zvogëluar qëllimin dhe kohzgjatjen e marrëveshjeve të ardhshme të marketingut për të siguruar një procedurë transparente dhe jodiskriminuese të marketingut. Në rastin konkret, Komisioni pranoi vetëm kontrata me kohzgjatje prej 3 vitesh, ku të drejtat të jenë të ndara dhe u janë shitur operatorëve të ndryshëm.

Referuar rastit në gjykim, shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm (DIGITALB) për një periudhë të gjatë (3 dhe 4 vjeçare) përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, në vlersimin e Gjykatës përbën një sjellje përjashtuese dhe me pasojë kufizimin e tregut, gjë e cila në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, përbën abuzim me pozitën dominuese.

Ekskluziviteti është një nga çeshtjet më të rëndësishme në lidhje me shitjen e përbashkët dhe marrjen e të drejtave të transmetimit. Në këtë fushë, Komisioni Evropian i Konkurrencës ka miratuar tre vendime që i referohen “UEFA Champions League”; “Ligës Gjermane të Futbollit”; dhe “Ligës së Futbollit Anglez”. Në këto vendime, Komisioni ka evidentuar se shitja e përbashkët përbën një kufizim të konkurrencës në kundërshtim me nenin 101 (1) të TFEU-së, meqë pengon konkurrencën midis klubeve në kuptimin e marketingut të të drejtave të tyre individualisht dhe prandaj mund të pengojë konkurrencën midis klubeve në aspektin e çmimeve, risi, shërbime dhe produkte të ofruara për tifozët.

Nga Komisioni është pranuar shitja e përbashkët në bazë të nenit 101 (3) të TFEU-së, me disa masa të caktuara në *case by case*. Në veçanti, Komisioni ka kërkuar modifikime dhe angazhime të caktuara, duke përfshirë p.sh: një kohzgjatje të shkurtër dhe një fushë të kufizuar për të drejtat ekskluzive mbi bazë të një procedure transparente.

Referuar rastit në gjykim, kontratat e lidhura ndërmjet FSHF dhe DIGITALB me nr.1209 prot., datë 15.09.2015, dhe nr.1001 prot., datë 18.09.2018, janë *“kontrata ekskluziviteti”* ku përfshihet *“Kategoria Superiore”* dhe *“Kupa e Shqipërisë”* me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshje kryesore të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera).

FSHF (palë paditëse në këtë gjykim) nuk bën të qartë në qëndrimin e saj së përse është bërë dallimi në ofertë për të dy kompeticionet, pavarisht së këto kopeticione janë të ndara ndërmjet tyre. Ndarja që është bërë në ofertë me paketën A dhe B, por që përfshin të dy kompeticionet, në vlersimin e Gjykatës është abuzim me pozitën dominuese, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 *“Për mbrojtjen e konkurrencës”* të ndryshuar.

Gjykata çmon se ndarja në ofertën për shitjen e të drejtave televizive ndërmjet *“Kategorisë Superiore”* dhe *“Kupës së Shqipërisë”* e bën më efektive pjesmarrjen e subjekteve të tjera të interesuara për transmetimin e tyre, ndoshta duke bërë dhe oferta që nuk përfshijnë të drejtat ekskluzive. Diferencimi në oferta mund të nxisë kërkesën për pjesmarrje të ndërmarrjeve që operojnë në transmetimin e aktiviteteve sportive dhe rrjedhimisht dhe konkurrencën ndërmjet tyre.

Siç u theksua më sipër, pavarisht se sipas stausit të saj FSHF është një organizatë jofitimprurëse, ajo kryen aktivitet ekonomik dhe gjeneron të ardhura nga shitja e të drejtave të transmetimit televiziv, nga shitja e biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare, sponsorizime dhe reklama etj., të cilat sipas parashikimeve të Ligjit nr.9121/2003 dhe praktikës së BE-së, dhe vendeve anëtare të saj, përfshihen në objektin e veprimtarisë dhe fushën e zbatimit të këtij ligji.

Një aspekt tjetër i gjenerimit të të ardhurave nga FSHF është shitja e *“Highlitet”* të ndeshjeve. *“Highlitet”* janë element jo kryesor i kontratave të lidhura midis FSHF dhe DIGITALB, por janë plotësues dhe si i tillë në vlersimin e Gjykatës, nuk duhet detyrimisht të përfshihen në ekskluzivitetin e saj. *“Highlitet”* janë një mundësi për të përfshirë edhe subjekte të tjera audiovizive që shfaqin interes në shfaqjen e tyre, duke rritur kështu pjesmarrjen e subjekteve që mund të promovojnë sportin dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve në treg. Ky ekskluzivitet shtesë i dhënë, në vlersimin e Gjykatës kufizon konkurrencën, pasi i heq mundësinë ndërmarrjeve të tjera që operojnë në tregun audioviziv për të marrë pjesë, dhe përbën abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 *“Për mbrojtjen e konkurrencës”* të ndryshuar.

Në lidhje me sponsorizimit, sikurse u theksua më sipër ata përbëjnë një nga të ardhurat ligjore të FSHF, e cila duhet të jenë e hapur për çdo subjekt që dëshiron të mbështesë ekipin kombëtar pa asnjë kufizim. Neni 34 i Ligjit nr.97/2017 “Për sportin” parashikon se organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjediseve sportive, për reklamimin e shoqërive të ndryshme tregtare, në bazë të marrëveshjes kontraktuese me to. Siç vërehet nga ky formulim, ligji nuk ka parashikuar asnjë procedurë, garë apo formalitet tjetër veç shprehjes së vullnetit të përbashkët me marrëveshje.

Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se kontratat e lidhur midis FSHF dhe DIGITALB, përkatësisht kontrata me nr.1209 prot., datë 15.09.2015, dhe kontrata me nr.1001 prot., datë 18.09.2018, në pikën 4.3 të tyre kanë parashikuar se: *“Reklamat e klientëve të Digitalb, që janë konkurrentë të drejtpërdrejtë të sponsorve të përgjithshëm të FSHF, nuk kanë të drejtë të transmetohen gjatë pjesës së parë dhe pjesës së dytë të ndeshjes. Ndërsa blloku publicitar i klientëve që nuk konkurrojnë sponsorët e përgjithshëm të FSHF, do të transmetohen në një bllok të veçantë publicitar”*.

Në vlersimin e Gjykatës, ky parashikim përbën një kufizim të reklamimit të aktivitetit të ndërmarrjeve që janë konkurrent të sponsorve të FSHF, duke vendosur në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121/2003, kushte të padrejta tregtimi.

Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Konkurrencës është konstatuar një lidhje që ekziston midis subjekteve që sponsorizojnë FSHF dhe pjesmarrjes së tyre me të drejta pasurore në kompaninë DIGITALB.

Kështu, sipas faqes së saj zyrtare, sponsor i FSHF-së është AMA Caffè (emri zyrtar New Century). Në këtë shoqëri Z.Agim Zeqo zotëron 55% të kuotës së kapitalit, i cili në të njetën kohë është edhe aksioner i DIGITALB.

Shoqëri sponsorizuese Union Bank ka lidhje me subjektet të cilët janë aksionerë të DIGITALB. Kështu, në shoqërinë Union Bank sh.a, Z.Edmond Leka dhe Z.Niko Leka, zotërojnë respektivisht 1.77% të aksioneve, ndërkohë që këta dy individ janë zotërues në mënyrë të drejtpërdrejtë të 35% të aksioneve secili tek shoqëria Union Grup sh.a, dhe janë zotërues të 42.5% të kuotës së kapitalit secili tek shoqëria “Arch Investor” sh.p.k, dhe zotërojnë në mënyrë indirekte, nëpërmjet shoqërisë “Union Net” nga 35% të kapitalit secili të shoqërisë “Union Distribution Servis Albania” sh.p.k. Sa më sipër, në mënyrë direkte dhe indirekte Z.Edmond Leka dhe Z.Niko Leka, zotërojnë aksione në shoqërinë “DIGITALB” sh.a dhe “Union Bank” sh.a.

Gjithashtu, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se ka ndërlidhje të interesave pasurore të përfaqësuesve ligjorë të FSHF, me pjesmarrjen e tyre në aksionet e shoqërisë “GIGITALB”. Nga ekstraket e QKB, rezulton se shoqëria “A.I.B.A”, kompani me aksioner të vetëm Z.Armand Duka, zotëron 9.23% të aksioneve të shoqërisë “DIGITALB”. Po ashtu, Z.Armand Duka, në shoqërinë sponsorizuese “AMA Caffè” (New Century) zotëron 22.5% të kuotës së kapitalit, i cili në të njëjtën kohë është dhe përfaqësuesi ligjor (President) i FSHF.

Gjatë procedurës hetimore të kryer nga Komisioni i Konkurrencës është analizuar edhe çmimi i shitjes së biletave. Nga ana e FSHF, nuk është paraqitur asnjë e dhënë/informacion mbi mënyrën se si është përlllogaritur ky çmim. Në mungesë të informacionit të një modeli të koston të detajuar të shërbimeve, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është përdorur alternativa krahasuese në lidhje me çmimin e biletave, si një nga metodat kryesore të hetimit, duke i krahasuar me vendet e rajonit si: Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kroacia, shtete me karakteristika të ngjashme me Shqipërinë, duke parë kriterin e Prodhimit të Brendshëm Bruto(PBB-së) dhe faktorë të tjerë si popullariteti i futbollit në këto vende.

Duke mos patur një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave me qëllim orientimin drejt koston të shërbimit, nga krahasimi i çmimeve të biletave të miratuara nga FSHF me çmimet e biletave të rajonit, ka rezultuar se ata janë më të larta se Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Kroacia. Kjo sjellje e FSHF, duke aplikuar çmime të larta pa patur një metodologji për përcaktimin e çmimit të biletave, çmohet nga Gjykata se përbën një abuzim me pozitën dominuese, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121/2003.

Gjykata thekson se duke qene se pala paditëse ka pozitë dominuese është e detyruar që të hartojë një metodologji për caktimin e çmimit të biletave, në mënyrë që ky çmim të mos jetë abuziv por të jetë i orientuar drejt koston. Nuk është justifikim për palën paditëse fakti i ndërtimit të stadiumeve apo investimeve të tjera, për mos të bërë një analizë ekonomike se sa është ky ndikim në çmimin e biletës apo të faktorëve të tjerë, por caktimi i çmimit të lihet në mënyrë abuzive.

Gjithashtu, gjatë procedurës hetimore nga Komisioni i Konkurrencës janë marrë në shqyrtim dhe ankesat e disa qytetarëve, lidhur me detyrimin për blerjen e biletës Shqipëri-Andora, në mënyrë që të shikohet ndeshja tjetër Shqipëri-Francë, që nga Gjykata çmohet gjithashtu se përbën një abuzim me pozitën dominuese, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa “a” të Ligjit nr.9121/2003.

Përfundimisht, nga sa u analizua më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesëpadia e paraqitur nga Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF), duhet rrëzuar tërësisht si e pa bazuar në ligj e në prova.

410

PËR KËTO ARSYE


Gjykata, bazuar në nenet 126 e 306 të K.Pr.Civile, si dhe në nenin 40/3 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" i ndryshuar.

VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesëpadiisë së paraqitur nga pala paditëse Federata Shqiptare e Futbollit, si të pa bazuar në ligj e në prova.
- Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e njofimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Tiranë sot me datë 21.09.2020.

SEKRETARE

Griselda DORESI



GJYQTARI

Avni SEJDI



SHËRNDAR / SIA / 1
AL
07 OCT / 2020
101 / 14
TIRANA

[shqipetaria.com]